



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR

ORGANIZIMIN E AKTIVITETEVE TË FORMIMIT PROFESIONAL

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 217, datë 31.10.2018

PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Kjo rregullore synon të përcaktojë rregullat për organizimin dhe zhvillimin e trajtimeve për kualifikime profesionale për profesionet që licencohen/miratohen nga Autoriteti.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë të nenit 14, nenit 20 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe nenit 38 të Rregullores nr. 130, datë 31.08.2017 “Për organizimin dhe përshkrimin e detyrave”.

Neni 3
Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet për:

1. Personat fizikë të cilët kërkojnë të licencohen/miratohen nga Autoriteti si anëtarë të organeve drejtuese të personave juridikë që licencohen nga Autoriteti;

2. Personat fizikë të cilët kërkojnë të licencohen/miratohen nga Autoriteti për të ushtruar veprimtari në profesione që licencohen nga Autoriteti;
3. Personat fizikë të cilët kërkojnë të rinovojnë licencën/miratimin e Autoritetit për të ushtruar veprimtari në profesione që licencohen nga Autoriteti.

Neni 4 **Përkufizime**

Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Trajnim” është një aktivitet mësimor në grup, që zhvillohet nga Autoriteti (10-25 vetë), me orientim të theksuar drejt praktikës profesionale, që gërsheton dhënien e leksioneve me metoda të tjera pedagogjike. Qëllimi është që pjesëmarrësit të përfitojnë njohuri, aftësi/shprehi ose kompetenca që u nevojiten për të përmbushur ushtrimin e profesionit në mënyrë të kënaqshme;
2. “Kualifikim profesional” është një sistem njohurish, aftësish, qëndrimesh dhe vlerash, të përftuara në aktivitete të formimit profesional, të cilat mundësojnë ushtrimin me sukses të një aktiviteti profesional, i cili mund të përftohet nëpërmjet mësimnxënies. Termi “Kualifikim profesional” përfshin “Kualifikim profesional bazë” dhe “Kualifikim profesional në vazhdimësi”;
3. “Kualifikim profesional bazë” është një sistem njohurish, aftësish, qëndrimesh dhe vlerash profesionale, të përftuara me anë të së cilave personi vërteton aftësinë për të ushtruar një aktivitet profesional të licencuar/miratuar nga Autoriteti;
4. “Kualifikim profesional në vazhdimësi” është një sistem njohurish, aftësish, qëndrimesh dhe vlerash profesionale, të përftuara gjatë periudhës së vlefshmërisë së licencës/miratimit dhe me anë të së cilave personi vërteton përditësimin dhe zgjerimin e njohurive e aftësive profesionale, të nevojshme për të rinovuar të drejtën për të ushtruar një aktivitet profesional të licencuar/miratuar nga Autoriteti;
5. “Program i kualifikimit profesional në vazhdimësi” është sistemi i bazuar në cikle periodike, që përputhet me periudhën e vlefshmërisë së një licence/miratimi të dhënë nga Autoriteti, brenda të cilit personi duhet të plotësojnë një numër minimal të domosdoshëm kreditesh të vlefshme me qëllim që të vërtetojë përditësimin dhe zgjerimin e njohurive e aftësive profesionale, për të rinovuar të drejtën për të ushtruar aktivitetin profesional. Niveli i krediteve minimale të vlefshme për një cikël të programit të kualifikimit profesional në vazhdimësi sipas profesioneve që licencohen miratohen nga Autoriteti përcaktohen në ankesin 1 bashkëlidhur kësaj rregulloreje;
6. “Kredit” është njësia që përdoret për të përcaktuar masën e ndjekjes së aktivitetit të konsideruar të përshtatshëm për vlerësimin e Kualifikimit Profesional.

Neni 5

Aktivitetet e formimit profesional

1. Autoriteti organizon dhe zhvillon aktivitete të formimit profesional, për profesionet që licencohen/miratoohen nga Autoriteti, për “Kualifikim profesional bazë” dhe “Kualifikim profesional në vazhdimësi”.
2. Autoriteti përgatit dhe publikon brenda datës 31 janar të çdo viti programin vjetor të aktivitete të formimit profesional.
3. Autoriteti publikon në faqen zyrtare web të internetit të Autoritetit (www.amf.gov.al), njoftimin për zhvillimin e çdo aktiviteti të formimit profesional. Publikimi bëhet të paktën 10 ditë para datës së zhvillimit të aktivitetit dhe përmban të dhëna për kohën, vendin e zhvillimit të tij, si dhe programin, temat që do të trajtohen dhe lektorët e angazhuar.
4. Personat e interesuar për të marrë pjesë në aktivitetet e formimit profesional të organizuara nga Autoriteti duhet të paraqesin deri dy ditë pune para datës së njoftuar për zhvillimin e aktivitetit të formimit profesional, kërkesën për pjesëmarrje në një nga format e mëposhtme:
 - a. Në formë shkresore në zyrën e protokollit të Autoritetit;
 - b. Në formë elektronike në postën elektronike të Autoritetit amf@amf.gov.al.Për kërkesat e paraqitura përtej afatit të parashikuar në këtë pikë, nuk do miratohet pjesëmarrja në aktivitet.
5. Pjesëmarrja në aktivitetet e formimit profesional dokumentohet nëpërmjet konfirmimit (nënshkrimit) të pjesëmarrësit në fillim dhe fund të çdo dite të aktivitetit, në listën e pjesëmarrësve.
6. Në përfundim të çdo aktiviteti të formimit profesional, Drejtoria e Mbrojtjes Konsumatore, regjistron kreditet e përftuara në regjistrin e krediteve dhe përgatit vërtetimin për çdo pjesëmarrës për konfirmimin e frekuentimit të aktivitetit dhe kreditet e përftuara.
7. Numri i krediteve llogaritet në bazë të kriterit 60 min = 1 kredit.

Neni 6

Kriteret për zgjedhjen e trajnerëve

1. Autoriteti për të mundësuar zhvillimin e aktiviteteve të aktivitetet të formimit profesional, sipas kësaj rregullore kontraktin trajnerë vendas apo të huaj. Trajneri duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:
 - a. Të ketë përfunduar ciklin e plotë të studimeve universitare;
 - b. Të zotërojë kualifikimin e nevojshëm në përputhje me modulën apo kurrikulën për të cilën do të angazhohen si trajner të vërtetuar me dëshmi, diploma, rekomandime apo vërtetime për eksperiencën profesionale;
 - c. Të ketë jo më pak se 7 vite përvojë pune në fushën përkatëse;
 - d. Zotërimi i gjuhës angleze përbën përparësi.

2. Për vërtetuar plotësimin e kriterëve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, trajneri duhet të depozitohet dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a. Curriculum Vitae;
 - b. Diplomë universitare;
 - c. Dokument që vërteton përvojën profesionale në fushën e kryerjes së trajnimit;
 - d. Projekt programi i detajuar, ku në mënyrë specifike do të jepet një përshkrim i çështjeve të trajnimit apo modulit për të cilin janë zgjedhur dhe literatura që do të përdoret.
3. Marrëdhënia e Autoritetit me trajnerët rregullohet nëpërmjet kontratave të punës me kohëzgjatje të caktuar.
4. Trajtimi financiar i trajnerëve bëhet sipas Rregullores nr. 83, datë 29.06.2011 “Mbi marrëdhëniet financiare të punonjësve me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” e ndryshuar.
5. Autoriteti krijon dhe mban bazën e të dhënave për trajnerët duke evidentuar trajnimet e kryera sipas programeve, si dhe vlerësimin për efektivitetin dhe aftësitë profesionale për të transmetuar njohuritë të personat e trajnuar. Ky vlerësim kryhet nga personat e trajnuar përgjatë zhvillimit të trajnimit.

Neni 7

Procedurat për zgjedhjen e trajnerëve

1. Përzgjedhja e trajnerit bëhet nga Autoriteti në varësi të fushës dhe programit të trajnimit duke u bazuar sipas radhës në një nga proceset e mëposhtme:
 - a. Bazës së të dhënave të Autoritetit për trajnerët me të cilët Autoriteti bashkëpunon;
 - b. Marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet Autoritetit dhe organizmave vendas apo të huaj;
 - c. Përzgjedhjes nëpërmjet një procedure të hapur të thirrjes për aplikim e cila publikohet në faqen web të Autoritetit.
2. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Drejtoria e Mbrojtjes Konsumatore përgatit raportin përmbledhës i cili përmban edhe propozimin për trajnerin e përzgjedhur. Pas miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, njoftohet trajneri dhe vijohet me nënshkrimin e kontratës përkatëse.

Neni 8

Regjistri i krediteve

1. Autoriteti krijon regjistrin e krediteve, i cili përmban të dhënat për kualifikimet profesionale për personat që licencohen/miratoohen nga Autoriteti për të ushtruar veprimtari në profesione në tregjet nën mbikëqyrje të Autoritetit.
2. Ky regjistër përmban të dhëna personale dhe profesionale për të gjithë individët të cilët kanë frekuentuar aktivitetet e zhvilluara nga Autoriteti. Regjistri i krediteve administrohet nga Drejtoria e Mbrojtjes Konsumatore.

Neni 9

Hartimi i programeve te formimit profesional

Programet e formimit profesional hartohen nga Drejtoria e Mbrojtjes Konsumatore dhe miratohen nga Bordi i Autoritetit. Për hartimin e programeve të formimit profesional, Autoriteti mund të bashkëpunojë me autoritete mbikëqyrëse vendase ose të huaj, shoqata profesionale, universitete publike dhe private, etj.

Neni 10

Shfuqizime

Rregullorja nr. 32, datë 28.05.2015 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së edukimit”, shfuqizohet.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

Aneks 1

Kreditet minimale të vlefshme për një cikël të programit të kualifikimit profesional në vazhdimësi sipas profesioneve

Profesioni	Cikli i programit të kualifikimit profesional në vazhdimësi	Kreditet minimale të vlefshme
Agjent në sigurime	3 vjet	18
Aktuar	3 vjet	40
Broker në sigurime	3 vjet	24
Vlerësues dëmsh në sigurime	5 vjet	24